



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 14 SHKURT 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 07.02.2019 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut” *(nenet 28, 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektvendimi “Për miratimin e kandidaturave për pozicionet e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit” *(neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë me shumicë të thjeshtë)*

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Koha e votimit

5. I bartur për votim: projektvendimi “Për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar” *(neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë me shumicë të thjeshtë)*

6. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*.

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi – Media është e futur brenda.

Seancën e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Siç e shikoni, sot seancën e parlamentit e nderon me pjesëmarrjen e tij, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, zoti Talat Xhaferi.

Ju faleminderit!

(Duartrokitje në sallë.)

Të gjithë jemi njohur me ngjarjen tragjike të aksidentit të ndodhur në Gostivar, ku deri tani kanë humbur jetën 15 qytetarë të Maqedonisë së Veriut. Për të nderuar dhimbjen dhe për t'iu gjendur familjeve që kanë humbur të dashurit e tyre, ftoj Kuvendin të mbajë një minutë heshtje.

(Mbahet një minutë heshtje.)

U prehshin në paqe!

I nderuar zoti Talat Xhaferi, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është një ditë e shënuar për Kuvendin e Shqipërisë, për vendin tonë, për rajonin dhe për Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Një anëtar i ri, Republika e Maqedonisë së Veriut, është pranuar si anëtar i 30-të në gjirin e aleancës më të madhe mbrojtëse të kohës.

Për t'ia arritur kësaj dite, vendi mik, fqinj dhe partner i Republikës së Shqipërisë ka kaluar sprova të mëdha. Njëren prej tyre, atë më të vështirën, sapo e kapërceu nëpërmjet një kuraje, guximi, vullneti e dëshire për progres, zhvillim, partneritet, stabilitet dhe paqe.

Dhe ja ku jemi sot, në ditën e shumëpritur nga të gjithë.

Protokolli për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO u nënshkrua më 6 shkurt 2019 nga përfaqësuesit e plotfuqishëm të 29 vendeve anëtare të NATO-s.

Ratifikimi i protokollit nga parlamentet e vendeve anëtare ka nisur. Unë shpreh kënaqësinë që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është ndër parlamentet e para që po e ratifikon këtë protokoll, duke nisur kështu hapin ligjor përfundimtar, i cili do të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Traktatin e Atlantikut të Veriut, duke e bërë kështu Maqedoninë e Veriut anëtare të NATO-s.

Ky hap i madh u bë i mundur në saj të Marrëveshjes së Prespës midis dy fqinjëve tanë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Parlamentet dhe qeveritë e të dyja vendeve dëshmuuan një shkallë të lartë emancipimi dhe përgjegjësie politike, kombëtare e rajonale, duke këputur nyjën që mbante pezull, natyrisht, pa e merituar, miqësinë dhe partneritetin midis të dy vendeve, si dhe rrugëtimin euroatlantik të Maqedonisë së Veriut.

Të dyja shtetet meritojnë, së pari, kredencialet më të mëdha për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO.

Ne e kemi të qartë se kjo nuk do të ishte bërë e mundur pa vullnetin, pa guximin politik dhe pa emancipimin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe të forcave politike që i përfaqësojnë ata.

Partitë politike shqiptare, pa dallim orientimi politik, qofshin në qeverisje apo në opozitë, kapërcyen polarizimin politik e dallimet ideologjike dhe votuan me vetëdije të plotë ndryshimet kushtetuese, që i hapën republikës së tyre dritën jeshile për në NATO. Me këtë qëndrim ata u treguan europianistë dhe euroatlantikas të vërtetë. Ky qëndrim nuk ishte i papritur, të gjithë kemi pasur rastin ta konstatojmë këtë, ndërsa unë, gjatë vizitës sime të fundit në Maqedoninë e Veriut para disa javësh, pata rastin ta prek nga afër.

Dua të përshëndes në emër të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe në cilësinë time si Kryetar i Kuvendit, vizionin e qartë euroatlantik të udhëheqësve politikë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, në mënyrë të veçantë të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kolegut dhe mikut tonë të nderuar, zotit Talat Xhaferi. Ju faleminderit, zoti Xhaferi, që me qëndrimet tuaja dëshmuat frymën euroatlantike tuajën, por edhe të të gjithë shqiptarëve të rajonit!

Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO është një vlerë e shtuar në progresin euroatlantik të të gjithë rajonit për zhvillim, për paqe dhe për stabilitet rajonal dhe global, por edhe më shumë se kaq. Anëtarësimi në NATO nuk është thjesht bashkimi në një organizatë politike, por në një familje vlerash. NATO-ja nuk është thjesht një aleancë mbrojtëse ushtarake, por një koalicion dhe bashkim vlerash, vullnetesh për progres, zhvillim dhe

mirëqenie. Në këtë organizatë kontributi i Shqipërisë dhe i rajonit tonë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Ju faleminderit!

Gjithashtu, dua të përshëndes të gjithë spektrin politik të parlamentit shqiptar, që në komisionet e Kuvendit të Shqipërisë ka shprehur vullnetin për të ratifikuar këtë protokoll.

Faleminderit!

Fjalën e ka Kryeministri, zoti Rama.

Edi Rama - I nderuar Kryetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,

I nderuar Kuvend i Shqipërisë,

Zija e sotme në vendin fqinj e rëndon akoma më shumë në vetëdijen tonë peshën e faktit se fati ynë është i përbashkët, një fat i përbashkët, i cili në këtë seancë mishërohet në mënyrën më kuptimplotë në ratifikimin e Protokollit të Aderimit në NATO të Maqedonisë së Veriut. Numri tronditës i viktimave dhe i të plagosurve në aksidentin tragjik, për ko incidencë më së shumti shqiptarë, na e bën sot edhe emocionalisht shumë më të prekshme afërsinë e lidhjes sonë me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo lidhje tërësisht e veçantë historike dhe politike gjen mishërim edhe në aktin tërësisht historik dhe politik të votimit të sotëm unanim të Kuvendit të Shqipërisë. Ne u jemi pranë shpirtërisht të gjitha familjeve të goditura nga tragjedia dhe do të bëjmë patjetër pjesën që na takon në përpjekjen solidare për të lehtësuar sadopak dhimbjen e tyre të madhe.

I kemi qenë pranë, pa asnjë ngurrim, vendit fqinj në të gjithë rrugëtimin e vështirë të anëtarësimit në NATO. E kemi bërë me këmbëngulje pjesën tonë përgjatë atij rrugëtimi, në mbështetje të popullit maqedonas dhe popullit shqiptar të Maqedonisë së Veriut.

Nuk e fsheh dot kënaqësinë e veçantë që ky moment solemn i celebrimit, me votën e Kuvendit të Shqipërisë, të aderimit të vendit fqinj në NATO, përkon me një kohë të artë të marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet dy popujve shtetformues të Maqedonisë së Veriut. Po ashtu nuk jam dot aq modest sa të mos sjell sot në vëmendjen e këtij Kuvendi rolin e pamohueshëm të kësaj shumice qeverisëse në mundësimin e këtij momenti të artë.

Kujtoj këtu se jo shumë larg në kohë gjuha shqipe u bë mollë sherri në politikën e brendshme të vendit fqinj dhe e ashtuqajtura

platformë e Tiranës u tregua si dora e djallit në punët e brendshme të Maqedonisë së Veriut.

Ndërsa pak ditë më parë Shkëlqesia e Tij, kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, i nderuari Talat Xhaferi, drejtoi seancën historike të punimeve parlamentare në gjuhën shqipe.

(Duartrokitje në sallë)

Pa shqiptarët nuk do të kishte Maqedoni të Veriut. Për Shqipërinë integriteti territorial i Maqedonisë së Veriut, bashkëjetesa e vërtetë demokratike ndërmjet dy popujve tanë në territorin e Republikës fqinje dhe gjuha shqipe në atë territor janë jo vetëm të pacenueshme, por edhe jetike për të sotmen dhe të ardhmen tonë, gjithashtu për paqen dhe stabilitetin në rajon. Por roli ynë në këtë proces historik ka qenë, sidoqoftë, një rol mbështetës dhe jo një rol udhëheqës. Ndaj, nëse sot situata në Maqedoninë e Veriut është më e mirë se asnjëherë tjetër në aspektin e marrëdhënieve politike ndëretnike, kjo i dedikohet, në radhë të parë, rolit konstruktiv të lidërshit politik shqiptar në atë vend, si dhe pa diskutim lidërshit vizionar dhe kurajoz, Kryeministrit Zoran Zaev, të cilin gjej rastin ta përshëndes solemnisht nga kjo seancë për arritjen historike të anëtarësimit në NATO, si dhe ta përgëzoj edhe një herë për dorën e shtrirë të vëllazërisë në drejtim të shqiptarëve.

Në të vërtetë Republika e Maqedonisë së Veriut, nën udhëheqjen e Kryeministrit Zaev dhe me mbështetjen vendimtare të partive politike shqiptare atje, ka dhënë një shembull tejet frymëzues me Marrëveshjen e Prespës, duke treguar se si historia mund ta shkruajë të ardhmen dhe jo veç ta ndalojë atë, se si lidërshipi vizionar dhe kurajoz i dy njerëzve mund të zhbëjë një nyje tradicionale në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, apo se si interesat e dy popujve, që formojnë një shtet, mund të njësohen me interesin e lartë të vetë shtetit, kur të zgjedhurit janë në lartësinë e interesit të zgjedhësve.

Uroj që më shpejt sesa vonë të mund të kremtojmë ardhjen e kompromisit edhe në fund të procesit të dialogut tonë me Greqinë, apo ajo që është më e rëndësishme për shqiptarët, për rajonin dhe për vetë Europën në procesin e stërmundueshëm të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Është tejet e vërtetë se pa Marrëveshjen e Prespës nuk do të kishte Maqedoni të Veriut në

NATO dhe, po ashtu, as mundësi përparimi në rrugëtimin e integritetit evropian për Maqedoninë e Veriut.

Sigurisht që pa mirëkuptimin dhe unitetin ndërmjet forcave progresiste maqedonase dhe atyre shqiptare nuk do të kishte Marrëveshje të Prespës. Patjetër që pa një lidhshmëri vizionare dhe kurajoz në anën maqedonase nuk do të kishte mirëkuptim dhe unitet ndërmjet palëve të atjeshme.

Është e qartë që anëtarësimi në NATO ose vazhdimi i rrugës së integritetit evropian ishin dhe mbeten shtysa të mëdha për shtjellën pozitive që morën marrëdhëniet ndëretnike dhe ato politike në Maqedoninë e Veriut, por të mos e harrojmë se në fund fare të gjitha këto zhvillime meritojnë vlerësimin më të lartë jo për NATO-n, as për Europën, por për të mirat që ato do të sjellin me siguri më tej për fëmijët e sotëm dhe për ata që do të lindin nesër.

Marrëdhënia e Shqipërisë me Maqedoninë e Veriut ka hyrë tashmë në një fazë të re.

Le të bëjmë çmos që të nxjerrim më të mirën prej saj për njerëzit dhe për vendet tona. Le të votojmë sot me bindjen që më e mira është ende përpara nesh!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Fjalën e ka zoti Lulzim Basha.

Lulzim Basha – Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar bashkëqytetarë,

I nderuar mik i shtrenjtë, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, zoti Talat Xhaferri!

Sot nuk është një seancë normale për disa arsye. Akti i mbështetjes konsensuale nga të gjitha partitë politike të Kuvendit të Shqipërisë për ratifikimin e Marrëveshjes së Anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO duhet të ishte një mesazh feste, edhe në kushtet e krizës totale që po kalon vendi ynë, por ky mesazh feste po ndodh në kontekstin e një murti. Aksidenti tragjik i natës së mbrëmshme ka mbushur me dhimbje shpirtrat e familjeve të viktimave dhe ka tronditur thellë popullin shqiptar, popullin e Maqedonisë së Veriut, natyrisht edhe ne këtu. Ndaj, në këto momente, në këto orë të tmerrshme të dhimbjes, dua t'u drejtoj familjarëve të viktimave në emrin tim dhe

në emrin e Partisë Demokratike, ngushëllimet tona më të ndjera!

Ngushëllimet tona edhe juve, zoti Xhaferri, si përfaqësuesi më i lartë i shtetit fqinj, sot i pranishëm në këtë seancë!

Zoti jua lehtësoftë dhimbjet!

Ju lëntë me forcën e kujtimit të të dashurve tuaj!

Zonja dhe zotërinj,

Me të vërtetë, momenti i anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, të cilit po i afrohem, është një moment i veçantë. Personalisht, rikujtoj shokun, tronditjen dhe dhimbjen, me të cilën përjetuan 10 vjet më parë kolegët tanë nga Maqedonia, refuzimin e ftesës dhe të anëtarësimit në NATO për shkak të rrethanave tashmë botërisht të njohura.

Ndaj, kjo është meritë e madhe e të gjithë faktorit politik të fqinjit tonë e në veçanti e faktorit politik shqiptar, i cili kurrë nuk u lëkund nga kthjelltësia e prioritetëve, ku anëtarësimi në NATO spikati prej momentit të parë si prioritet i prioritetëve. Ky është qëndrimi i partive politike shqiptare në Maqedoni; ky është qëndrimi i shqiptarëve; ky është qëndrimi i kombit shqiptar kudo, i cili është kombi më proatlantik, kombi më proamerikan, kombi më proevropian i Ballkanit, ndoshta i Europës dhe i mbarë rruzullit.

Ëndrrën tonë për liri kombëtare dhe bashkim kombëtar ne e kemi formuar pikërisht përmes linjave, parimeve dhe vlerave të europianizmit dhe euroatlanticizmit.

Ndaj, më lejoni edhe një herë të konfirmoj këtu vizionin e palëkundur të Partisë Demokratike, prej ditës së parë të themelimit të saj, se çështja kombëtare është dhe mbetet ylli ynë polar. Problemi shqiptar në Ballkan merr zgjidhje përfundimtare me Kosovën e pavarur, në NATO dhe në BE, të pacopëzuar e të pacenuar në integritetin e saj territorial, me Maqedoninë në NATO dhe në BE, në zbatim të plotë të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Ohrit dhe nga të gjitha standardet e tjera evropiane dhe euroatlantike për popullin shtetformues shqiptar, që jeton në Republikën e Maqedonisë.

Progres domethënës ka pasur në këto ditë, në veçanti për sa i përket gjuhës shqipe. Unë jam i bindur se anëtarësimi i Maqedonisë në NATO do t'i shërbejë konsolidimit të këtyre

standardeve. Ndaj, inkurajoj dhe mbështes përpjekjet e faktorit politik shqiptar, e të gjithë faktorit politik në Maqedoni, për të realizuar plotësisht detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje paqeje, e orientuar nga e ardhmja.

Por, zonja dhe zotërinj, le të mos jemi as hipokritë, as të pasinqertë. Procesi i futjes së Maqedonisë së Veriut në NATO erdhi pas një përballjeje të fortë dhe finale midis jo thjesht dhe vetëm faktorëve që nuk e duan Ballkanin në NATO dhe në Europë, por edhe faktorëve që me korrupsionin dhe lidhjen e tyre me krimin e organizuar, ishin bërë pengesë totale për hapat e mëtejshëm të fqinjit tonë lindor.

Të gjithë i mbajmë mend skenat e shëmtuara në parlamentin e fqinjit tonë. Ato nuk ishin thjesht dhe vetëm përplasje midis palëve politike, por përplasje midis një qeverie dhe një shteti të kapur në çdo qelizë nga korrupsioni galopant, nga krimi i organizuar, nga rënia e shtetit ligjor dhe zëvendësimi me shtetin e mafies, nga përqendrimi i të gjitha pushteteve në një dorë, në një taraf, që kontrollonte qeverinë, parlamentin, shërbimet sekrete, drejtësinë, ekonominë dhe mediet.

Po kush jemi ne që të zgjatemi më shumë me hallet dhe problemet e Maqedonisë, aq më shumë tani që duket se i kanë vënë punët në rrugë të mbarë?! Skenari që sapo përshkrova është prapë se prapë shumë më i lehtë se ai ku gjendemi sot dhe ky është mort i dytë në të cilën jeni i pranishëm, zoti Xhaferri, mort i rënies së shtetit ligjor në Shqipëri; mort i rënies së demokracisë në Shqipëri.

Ju jeni sot i pranishëm në një sallë, që quhet Kuvendi i Shqipërisë, por që është i mbushur me njerëz, të cilët nuk kanë ardhur këtu si shprehje e vullnetit të qytetarëve të Shqipërisë, por si shprehje e vullnetit të bandave të krimit të organizuar, si shprehje e vullnetit të një grushti oligarkësh që kanë kapur qeverinë dhe e kanë detyruar atë të braktisë dhe të tradhetojë interesin publik; të braktisë dhe të tradhetojë detyrimet ndaj Bashkimit Europian. Kjo është arsyeja se pse në këtë ditë ne nuk mund të festojmë bashkë me ju, ndonëse na bëhet qejfi kur dëgjojmë miqtë tanë se jeni gati të merrni edhe dritën jeshile për hapjen e negociatave. Por me siguri edhe ju e dini që frika e tyre është se në këtë qershor Shqipëria nuk mund dhe nuk do ta marrë hapjen e negociatave.

Ndaj, më lejoni, zoti Xhaferri, duke ju falënderuar për praninë tuaj këtu, ta drejtoj pjesën time të fjalimit tashmë jo thjesht dhe vetëm ndaj kësaj salle, por drejt bashkëqytetarëve të mi, të cilët pasnesër do të mblidhen në protestën më të madhe që ky vend ka njohur në 30 vjet, për të diktuar përmes bashkimit të tyre atë që nuk kemi diktuar dot nga kjo sallë, ndarjen e politikës nga krimi, dhënien fund të vjedhjes, vjedhjes qeveritare, vjedhjes me ligj, vjedhjes me dekret të popullit shqiptar, sepse sot kemi një problem, mbi të gjitha problemet, i cili duhet të ishte zgjidhur e do të ishte zgjidhur, në mos me rrugën europiane, të paktën me rrugën e fqinjit tonë lindor, prej kohësh. Këta që kemi prapa nesh janë kapur në vjedhje, në flagrancë. Janë kapur në vjedhje në flagrancë duke vjedhur qytetarët më të varfër të Europës, janë kapur në vjedhje në flagrancë duke vjedhur ekonominë, taksat, janë kapur duke vjedhur votat e shqiptarëve.

Kjo qeveri dhe ky Kryeministër kanë vjedhur studentët, kanë vjedhur të pamundurit, kanë vjedhur banorët e Unazës së Re, kanë vjedhur teatrin, kanë vjedhur Tiranën, kanë vjedhur Durrësin, Shkodrën, Vlorën, Dibrën dhe Sarandën. Kjo qeveri ka vjedhur edhe votat, siç e tregoi “Zëri i Amerikës” me përgjimet e dosjes 339. Kjo qeveri hajdute u ka hequr bukën e gojës dhe vazhdon t’u heqë bukën e gojës përditë fëmijëve tuaj, të dashur bashkëqytetarë, për të mbushur xhepat e saj, xhepat e banditëve dhe të hajdutëve për të cilët punon. Kjo qeveri dhe ky kryehajdut janë sot lakuriq para syve tuaj dhe para syve të botës, sepse janë kapur duke vjedhur. Janë kapur duke ju vjedhur ju, qytetarë të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë, tek Unaza e Re, kur nisën të prishnin shtëpitë e njerëzve, të nxjerrin vogëlushët në rrugë për 18 milionë euro që do t’i merrte “DH Albania”, një kompani që nuk ekziston fare. Janë kapur duke vjedhur me OSHEE-në, që do t’i jepnin 12 milionë euro po kësaj kompanie që nuk ekziston fare. Gjithashtu, u kapën duke vjedhur në aferën 200 milionë euro për të shkatërruar Teatrin Kombëtar; u kapën duke zhvendosur lumin e Lanës për të prishur 700 shtëpi në mënyrë që kriminelin, trafikanti i drogës, miku i tyre të ndërtonte një kompleks me vlerë 60 milionë euro dhe të mos i prekej asnjë centimetër katror. Pastaj i keni parë vetë përgjimet e “Zërit të Amerikës” se si me

Gjushër, me Avdylër i kanë vjedhur dhe blerë votat, e keni parë sesi vetëm një hetim, disa minuta përgjim tregojnë manipulimin e votave në 4 qarqe të Shqipërisë.

Prandaj, zonja dhe zotërinj, këta hajdutë me lekët e vjedhura kanë blerë edhe këto karrige ku ulen përditë. 1 në 3 mandate nuk përfaqëson votën e socialistëve, por përfaqëson votën e kriminelëve, të trafikantëve të drogës, e narkokarteleve, që e kanë shndërruar këtë në një narkoqeveri dhe Shqipërinë në një narkoshtet, të cilën mediet ndërkombëtare dhe diplomatët e quajnë Kolumbia e Europës.

Ju ftoj të na tregoni se kush është Pablo Eksobari i Europës. Shqiptarët e dinë, por duhet ta thoni edhe ju, keni kohë që e vononi.

Këto karrige nuk janë në shitje, këto karrige nuk u përkasin këtyre, ju përkasin juve, të dashur qytetarë shqiptarë. Këto karrige janë vjedhur, janë blerë, por pushtetin e vërtetë e keni ju, ndaj duhet ta merrni vetë fatin në dorë.

Në Europë, aty ku duam të shkojmë, kur qeveria dhe kryeministri kapen duke vjedhur, ndëshkohet qeveria, ikin hajdutët në burg, nuk vuan populli.

290 mijë qytetarë shqiptarë hanë vetëm një vakt në ditë. Gjysma e shqiptarëve nuk harxhojnë dot më shumë se 5 mijë lekë të vjetër në ditë, në nivel familje, jo në nivel individ, ndërsa këta dhe ky vjedhin miliona. 4.5 milionë euro në 8 orë ka vjedhur kompania, të cilën gazetarët sllovenë e lidhin me familjarët e tij. Pra, vetëm me aferën e KESH-it janë vjedhur 4.5 milionë euro në 8 orë. Janë miliarda euro taksa, miliarda euro nga çmimi i rritur i energjisë dhe i naftës, të zhdukura nga xhepat tuaj, që nuk u kthyen kurrë as në rritje pensionesh, as në rritje rrogash, as në investime për ju, as në hapje vende pune. Mjerimi ka mbërthyer vendin nga jugu në veri, nga lindja në perëndim.

Por fjalëpistë, fyes, indiferent dhe poshtërues ndaj popullit, kryehajduti, që është kapur duke vjedhur, refuzon të japë të vetmen zgjidhje politike që mund të ketë sot vendi.

Zgjidhja politike e vetme për të shmangur krizën totale është ajo e një qeverie tranzitore, me një kryeministër të pakapur nga krimi dhe zgjedhje të parakohshme për të çuar një parlament me të vërtetë të popullit. Ne kemi bërë përpjekjet për t'i zgjidhur punët nga brenda.

Zonja dhe zotërinj, ne i kemi bërë të gjitha përpjekjet për t'i zgjidhur problemet në mënyrë institucionale dhe ligjore, me shpresën dhe besimin që kriza nuk do të thellohej dhe të vinte në një pikë pa kthim. I kemi bërë, sepse besojmë se ligji duhet të jetë i barabartë për të gjithë; sepse nuk mundet që një kryefamiljar të përfundojë në burg dhe të vrasë veten për një faturë të energjisë, ndërsa asnjë qeveritar të mos mbajë përgjegjësi kur kapet duke vjedhur miliona euro, siç u kapën tek Unaza. Nuk mundet që një grua shtatzënë të shoqërohet, sepse mbron pragon e derës nga fadromat shkatërrimtare të korrupsionit dhe Gjushërit me shokë të vazhdojnë të bredhin të lirë, edhe kur kapen duke vjedhur votat. Ne besojmë se ligji duhet të jetë i barabartë për të gjithë. Ne besojmë se detyra kryesore e shtetit, arsyeja përse ekziston është: të kujdeset për qytetarët duke u nisur nga ata që s'kanë asgjë, duke u dhënë dorën njerëzve, jo duke i vjedhur ata; duke i harxhuar paratë publike për investime që u vlejné në radhë të parë njerëzve, jo për të pasuruar një grusht oligarkësh; duke u përmirësuar jetën njerëzve; duke ua lehtësuar barrën e jetës, duke i ndihmuar që bizneset të rriten dhe të punësojnë, jo duke bërë projekte luksi; duke futur në punë shqiptarët që të rrisin mirëqenien e tyre, jo duke vjedhur lekët me korrupsion, bashkë me një grusht oligarkësh, jo duke paguar për projektet personale të shefit.

Kështu shkohet në Europë, me ligjin e barabartë për të gjithë, me zgjedhje të lira e të ndershme, me punë, me vlera, jo me vjedhje, gënjeshtër dhe hilerë. Ndaj Europa ua ka mbyllur derën këtyre. Por ajo derë duhet hapur, sepse ajo derë është shpëtimi ynë. Europë do të thotë mundësi, liri. Europë do të thotë vlera. Udhëtimi ynë drejt Europës është i dhimbshëm, duhet të jetë më i shpejtë dhe më i sigurt, por vetëm ky udhëtim, vetëm ky proces do të na çojë drejt shpëtimit, drejt çlirimit tonë nga e keqja që i ka zënë frymën shoqërisë, si dhe drejt mirëqenies.

Ndaj, zonja dhe zotërinj,

Vëllezër dhe motra,

Siç jeni mbledhur këtë muaj, duhet të vazhdojmë të mblidhemi rreth njëri-tjetrit, t'i japim dorën njëri-tjetrit, të gjejmë brenda vetes atë që na bashkon: e sotmja me hallet që ne jetojmë të gjithë dhe e ardhmja që të gjithë duhet të ndërtojmë së bashku.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 14 SHKURT 2019

Ndaj duhet të bëhemi të gjithë gati që kjo ditë, të mos vonohet më; ndaj, duhet që gjithsecili të japë ndihmën e tij, sepse ky është qëllimi ynë madhor si shoqëri. Ju shqiptarë, që e doni familjen tuaj, që e doni vendin tuaj, mund dhe do të bëheni shtytësit më të mëdhenj të këtij rrugëtimi. Ju nuk jeni pengesa, ju jeni shpëtimi i vendit nga kjo klikë hajdutësh të kapur në vjedhje. Ne i kemi të gjitha mundësitë, por në fillim duhet të heqim qafe këtë sistem të kalbur, që në fakt i përket dhe përbëhet vetëm nga një grusht njerëzish. Shumica dërmuese e shqiptarëve nuk kanë fituar asgjë prej këtij sistemi. Shumica dërmuese e shqiptarëve vidhen ditë për ditë nga ky sistem. Shumica dërmuese e shqiptarëve varfërohen çdo ditë nga kjo klikë hajdutësh. Shumica dërmuese e shqiptarëve poshtërohen ditë për ditë nga ky sistem dhe i pari i tij. Ndaj, ky sistem duhet përmbysur. Përmbysur!

Ne i provuam të gjitha: ta pastrojmë nga koka me ligje, me amendamente, me iniciativa, ta pastrojmë nga brenda. Sot të gjithë e kanë kuptuar se pa e përmbysur këtë sistem, nuk mund të ngremë asgjë të re dhe asgjë të mirë për njerëzit.

Ndaj, ditën e shtunë përballja është e qartë: matanë gardhit të policëve, është kryehajduti i kapur në vjedhje, përballë tyre është populli i vjedhur. Këtu ka përfunduar vendi, këtu e ka çuar kryehajduti. Një shtet i kapur që vetëm vjedh dhe mbron hajdutët kundër njerëzve, kundër shumicës së tradhtuar dhe kundër popullit të varfëruar në palcë. 16 shkurti është dita e madhe e bashkimit popullor, e bashkimit kundër vjedhjes, kundër qeverisë hajdute dhe e bashkimit për Shqipërinë si çdo vend evropian.

Derën e Europës ne do ta hapim të gjithë bashkë të shtunën më 16 shkurt. Ejani ta çlironi veten tuaj nga kjo humnerë! Ju jeni sovran, keni çdo ndryshim në dorë. Na ndihmoni që të kthejmë gjithçka në normalitet! Merrni në dorë fatin tuaj! Bashkohuni për një të ardhme dinjitoze!

Zoti e bekoftë Shqipërinë!

Zoti i bekoftë shqiptarët!

Gramoz Ruçi- Fjala për zotin Mediu.

(Ndërhyrje nga salla)

Zoti Mediu, një minutë!

Po, urdhëroni!

Të hapet mikrofoni i zotit Rama!

Edi Rama - I dashur miku ynë, Kryetar i Kuvendit të Maqedonisë, ju kërkoj ndjesë për këtë shkelje të kodit të mikpritjes, por dua t'ju siguroj se fëmiu që sapo foli, jo vetëm nuk i mendon ato që thotë, por thjesht nuk di se çfarë thotë.

Edhe një herë ju kërkoj ndjesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Gramoz Ruçi- Një minutë!

Po, zoti Vasili.

Petril Vasili- I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Ju kërkoj që ta ktheni në normalitet parlamentin në këtë ditë, kur kemi një temë të veçantë.

Së pari, dhe mbi të gjitha, Rregullorja e këtij parlamenti kërkon që në momentin që hapet një procedurë e caktuar...

(Deputeti Edi Paloka ngrihet nga vendi dhe i afrohet Kryeministrit, duke e spërkatur me bojë. – Bazuar në sistemin video të Kuvendit-)

Gramoz Ruçi - Paloka përjashtohet nga seanca.

Shërbimi ta nxjerrë jashtë.

Edi Paloka, dil jashtë nga salla!

Zoti Paloka, dil jashtë!

Deputeti Paloka, dil jashtë për veprimin e kryer në kundërshtim me të gjitha rregullat!

Dil jashtë!

Mos më detyro të mbledh Byronë!

Pushim!

Shërbimi të nxjerrë zotin Paloka jashtë.

(Pas ndërprerjes)

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë deputetë!

Media të futet brenda!

Deputeti Paloka, lironi sallën!

(Deputeti Paloka vazhdon të qëndrojë në sallë.)

Atëherë, kërkoj urgjent thirrjen e Byrosë së Kuvendit për të marrë në shqyrtim sjelljen në seancë plenare të Edi Palokës dhe moszbatimin e vendimit të Kryetarit të Kuvendit.

Byroja e Kuvendit të mblidhet menjëherë te salla përkatëse!

Ndërpritet seanca.

(Pas ndërprerjes)

Gramoz Ruçi – Të futet media!

Ju njoftoj se mbledhja e Byrosë, e zhvilluar pak më parë, ku morën pjesë vetëm anëtarët e shumicës parlamentare, pasi anëtarët e opozitës nuk ishin të pranishëm, vendosi të përjashtojë deputetin Edi Paloka për 10 ditë nga punimet e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare, shoqëruar kjo edhe me sanksionet përkatëse financiare, në zbatim të nenit 65, pika 2 e Rregullores së Kuvendit.

Zoti Paloka, lironi sallën!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, është e disata seancë rresht që Kryeministri demonstroi sjellje të papërgjegjshme, madje një sjellje prej rrugaçi, duke ofenduar në mënyrë të përsëritur zotin Paloka. Të njëjtën gjë bëri edhe sot me kryetarin e opozitës.

Nëse ju do të vazhdoni me këtë qëndrim dhe të mos e dënoni Kryeministrin për sjelljet rrugaçërore, që demonstroi në seancën e Kuvendit, atëherë jeni ju përgjegjës për këtë gjendje që krijohet këtu.

Edhe një herë ju kërkoj, siç kemi kërkuar në rastet e sjelljeve të ngjashme të Kryeministrit,

të merrni masa ndaj Kryeministrit, të mblidhni Byronë dhe ta përjashtoni atë.

Njëkohësisht, si zgjidhje për këtë seancë, ju propozoj të kaloni tani në votimin e projektligjit për miratimin e protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO dhe pastaj të merremi me punët tona.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Nxirreni deputetin Paloka jashtë, zoti kryetar i grupit!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Dil jashtë, zoti Paloka, që të mos dyfishohet masa e përjashtimit, në zbatim të Rregullores!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Uluni!

Procedura është e qartë, pasi të dalë zoti Paloka jashtë.

Ju lutem, uluni, zoti Basha! Jua dhashë fjalën për procedurë. Ia dhashë fjalën kryetarit të grupit, me kërkesën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Duke qenë se zoti Paloka nuk zbaton masën e marrë nga Kuvendi, këtu mbyllet debati për ratifikimin e protokollit të aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Kuorumi është i mjaftueshëm për votimin e marrëveshjes.

Hedhim në votim projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Në mbështetje të nenit 121 dhe nenit 122 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon shumicë absolute votash për miratim.

Hapet votimin në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 130 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë te shqyrtimi nën për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Fillojmë me nenin 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 130 deputetë pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Urime vendit fqinj!

Më lejoni të ftoj Kryetarin e parlamentit të Maqedonisë së Veriut për t'iu drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.

Zoti Talat, jeni i ftuar.

Talat Xhaferi – I nderuar Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Gramoz Ruçi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shkëlqesi,

Zonja dhe zotërinj,

I dashur popull shqiptar,

Fillimisht dua t'ju siguroj që këto situata nuk janë të parat, por kanë kaluar të gjitha sfidat, mbi të gjitha qëllimi ishte miratimi i protokollit.

Të nderuar përfaqësues të medieve,

Kam nderin që në emrin tim personal dhe në emër të deputetëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të shpreh kënaqësinë time personale dhe ndjenjën e krenarisë që sot jam dëshmitar për këtë akt kaq solem për ne, për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për të gjithë ata që kontribuuan për këtë ditë, të cilët na besuan dhe na mbështetën.

Sot përpara së gjithash jam dëshmitar i reflektimit të drejtpërdrejtë të miqësisë së vërtetë, fqinjësisë së sinqertë dhe mbështetjes së pakushtëzuar të një shteti vëllazëror, siç është Republika e Shqipërisë.

Marrëdhëniet mes dy shteteve tona janë të ndërthurura me fije të forta të miqësisë, por edhe me lidhje fafërisnore. Kemi raporte bilaterale në të gjitha nivelet politike më të larta, por edhe në fushën e bashkëpunimit ekonomik, kulturor, arsimor dhe turistik.

Ju jeni mbështetësit për nismat rajonale edhe para organizmave ndërkombëtarë multilateralë.

Të nderuar deputetë,

Besoj se jeni familjarizuar mirë me përpjekjet e shumicës parlamentare aktuale për ndërtimin e një imazhi të ri të shtetit brenda vendit dhe në raportet me fqinjët. Jemi të përkushtuar në ndërtimin e “një shoqërie për të gjithë”, pa dallim në përkatësinë etnike, fetare dhe sociale. Punojmë shumë në drejtim të bërjes së reformave në të gjitha sferat e jetës shoqërore

dhe ky proces nuk është aspak i lehtë, por synimi ynë është të bëjmë një shtet me të vërtetë demokratik me sundim të të drejtës dhe me institucione funksionale në shërbim të qytetarëve, prandaj punojmë me përkushtim.

U përqendruam maksimalisht në mbylljen e çështjeve që e ngarkonin rrugëtimin tonë, arritja e përcaktimeve tona strategjike, për anëtarësimin e plotfuqishëm në NATO dhe në BE.

Nënshkruam marrëveshje për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me Republikën e Bullgarisë.

Nënshkruam marrëveshjen përfundimtare për zgjidhjen e kontestit rreth emrit me Republikën e Greqisë.

Miratuam ndryshimet kushtetuese, gjë që nuk ishte aspak e lehtë dhe shkaktoi protesta nga të dyja anët, gjë që flet vetvetiu se marrëveshja është një kompromis vin-vin, ku të gjithë jemi fitimtarë dhe të gjithë jemi humbës.

Por, në fakt, fitoi largpamësia dhe guximi i shumicës parlamentare, fitoi vizioni për ardhmërinë e sigurt, fituan qytetarët tanë. E dinim ku donim të ishim dhe nuk hezitua në asnjë çast, pa dallim nga vështirësitë, sepse qytetarët tanë meritojnë të jenë qytetarë të lumtur, me të drejta dhe liri të barabarta, me vlera dhe standarde europiane, me mundësi dhe shanse të njëjta.

Ne nuk ishim dhe nuk jemi vetëm në këtë rrugëtim, sepse çdo herë i kemi pasur pranë miqtë dhe partnerët e vërtetë dhe për këtë u jemi mirënjohës pa masë.

Përpjekjet tona nuk dështuan dhe tani jemi në fazën e kalimit të kilometrave të fundit para anëtarësimit të plotfuqishëm në NATO dhe hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Në raport me NATO-n, ne shpresojmë që deri në fund të këtij viti ose në fillim të vitit 2020, protokollin për anëtarësimin e plotfuqishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, që para pak javësh u nënshkrua në mënyrë solemne në Bruksel nga ana e 29 ambasadorëve të shteteve anëtare, do të ratifikohet edhe nga 29 parlamentet nacionale dhe me këtë do të bëhemi anëtar i tridhjetë i plotfuqishëm, me të gjitha të drejtat dhe obligimet që ka çdo anëtar i NATO-s.

Para dy ditëve, Protokollin e ratifikoi Kuvendi i Republikës së Sllovenisë dhe

simbolikisht hapi derën për parlamentet e tjera nacionale.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ratifikoi sot Protokollin e Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me këtë rast dëshiroj t'ju falënderoj sinqerisht në emër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Republika e Shqipërisë dhe populli shqiptar edhe një herë konfirmuan raportin miqësor ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ndaj qytetarëve të saj. Të jeni të sigurt se ne do ta mbajmë mend gjithmonë dhe gjithmonë kemi ditur t'i respektojmë dhe t'i vlerësojmë miqtë tanë të vërtetë, Shqipërinë dhe shqiptarët.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**

Gramoz Ruçi – Zoti Xhaferi, urimet më të përzemërta të Kuvendit dhe të popullit shqiptar për këtë hap dhe për këtë arritje historike të Republikës së Maqedonisë së Veriut!

Faleminderit për mesazhet që i drejtuat Kuvendit të Shqipërisë!

Gjithashtu, ju kërkohet ndjesë për situatën e krijuar!

Mbyllim këtu seancën e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 12:30)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi